



# RIINVEST

**BPrAL KOLEGJI RIINVEST SH.A.**

**RREGULLORE PËR MBROJTJE DHE SIGURI NË PUNË**

*Shkurt 2019*

Në pajtim me kompetencat e dhëna në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës (Nr. 06/L-016 ) dhe Statutin e BPrAL Riinvest, e në pajtim me Ligjin e Punës (Nr. 03/L-212) dhe Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (Nr. 04/L-161), Bordi Drejtues i BPrAL Riinvest miratoi këtë **Rregullore Mbrojtje dhe Siguri në Punë.**

## **Neni 1 - Mbrojtja e përgjithshme në punë**

1.1 Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të përcaktojë masat e imponuara nga BPrAL Kolegji Riinvest (në tekstin e mëtejme Kolegji) për të siguruar mbrojtje dhe siguri të të gjithë personave të punësuar pranë Kolegjit, si dhe zotimet e Kolegjit për krijimin e një ambienti të sigurt të punës.

1.2 I punësuar ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit, dhe ambient të përshtatshëm të punës, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës që rregullon fushën e punës, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së shëndetit.

1.3 Kolegji zotohet të të sigurojë kushte të përshtatshme të cilat sigurojnë mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të të punësuarve në pajtim me legjislacionin e përkufizuar në paragrafin 2 të këtij neni.

1.4 Të gjitha rregullat e Kolegjit mbi punët dhe shërbimet e kryera në dobi të Kolegjit, orarin e punës, punën jashtë orarit dhe aspekte tjera të sigurisë në punë janë në harmoni me legjislacionin primar të Republikës së Kosovës që rregullon këto sfera.

## **Neni 2 - Mbrojtja e të rinjve**

2.1. Personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punësohen në Kolegjin Riinvest me kontratë të rregullt. Në raste të veçanta angazhimi i personave nën moshën 18 vjeçare mund të bëhet duke pas parasysh natyrën apo rrethanat nën të cilat kryhen aktiviteti, i cili nuk mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë apo moralin e tij.

2.2 Angazhimi i personave nën moshën madhore në aktivitetin e Kolegjit mund të bëhet vetëm për arsye të ofrimit të përfitimeve për ta si dhe kushteve për të kryer punë praktike pranë Kolegjit. Kolegji do të përmbahet nga angazhimi i personave nën moshën madhore për realizimin e çfarëdo aktiviteti fitimprurës për Kolegjin.

2.3 Angazhim i të rinjve në çdo rast do të realizohet vetëm nën kushtet e përcaktuara në legjislacionin e punës dhe mbrojtjes në punë.

### **Neni 3 - Mbrojtja e femrave të punësuar**

Kolegji dhe organet udhëheqëse të tij do të respektojnë në tërësi dispozitat e ligjit të punës dhe mbrojtjes në punë që ndërlidhen me angazhimin e femrave në punë të rënda fizike, punësimin dhe pushimet dhe lejet e mungesës për femrave shtatzënë, pushimin e lehonisë dhe mungesës për arsye të gjdhënies.

### **Neni 4 - Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara**

4.1 Kolegji do të zbatojë në përpikëri parimin e barazisë në punësim, pa diskriminuar personat në çfarëdo baze, përfshirë në bazë të aftësisë së kufizuar të tyre.

4.2 Pa paragjykuar paragrafin 1 të këtij neni, Kolegji zotohet të zbatojë politika pozitive të punësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe të ofrojë kushte të qasjes në stabilimentet dhe materialet e Kolegjit për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

### **Neni 5 – Obligimet e Kolegjit**

5.1 Në kuadër të përgjegjësisë së veta, Kolegji detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurtë, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, dhe masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.

5.2 Kolegji në vazhdimësi ka vepruar në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike.

5.3. Kolegji u përgjigjet të punësuarve për dëmet e shkaktuara nga lëndimet në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

5.4 Kolegji aplikon masat parandaluese të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit për mbrojtje dhe siguri në punë në Republikën e Kosovës.

5.5 Kolegji dhe të punësuarit janë të detyruar të bashkëpunojnë në zbatimin e rregullave për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, në pajtim

## **Neni 6 - Ndhimja e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i të punësuarve, rreziqet serioze dhe të mundshme**

6.1 Kolegji ka ndërmarrë të gjitha masat e trajnimit të stafit dhe i ka certifikuar ata sipas standardeve të përcaktuara ligjore për ofrimin e ndihmës së parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarve dhe studentëve të Kolegjit në rast nevojë.

6.2 Kolegji ka ndërmarrë dhe do të mbajë të zbatueshme të gjitha masat e përcaktuara të mbrojtjes nga zjarri, në pajtim me legjislacionin pozitiv të Republikës së Kosovës.

6.3 Kolegji ka vendosur dhe do të mirëmbajë, në baza të rregullta, pajisjet e fikjes së zjarrit, të cilat janë të vendosura në bazë të standardeve të përcaktuara për sipërfaqen dhe konfiguracionin e stabilimenteve të Kolegjit.

6.4 Kolegji ka planin e evakuimit emergjent dhe stabilimentet përkatëse për rastet e rreziqeve serioze të cilat mund të shfaqen gjatë zhvillimit të veprimtarisë së vet, përfshirë shkallët emergjente.

## **Neni 7 Vlerësimi i rrezikshmërisë dhe informimi në vendet e punës**

7.1 Kolegji i ka përcaktuar vendet dhe hapësirat me rrezikshmëri për punonjësit e vet, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

7.2 Kolegji merr masa adekuate që të punësuarit të marrin të gjitha informatat e nevojshme lidhur me çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, masat mbrojtëse dhe parandaluese si dhe aktivitetet që duhet ndërmarrë nga ta për eliminimin e këtyre rreziqeve.

## **Neni 8 Kontrollimet mjekësore**

8.1 Punonjësit në Kolegji janë të obliguar t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor së paku një herë në çdo tri (3) vite përvojë pune.

8.2 Punonjësit në Kolegj do ta dëshmojnë kalimin e kontrollit mjekësor duke paraqitur tek Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit certifikatat mjekësore, në intervalet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Neni 9 Aksidenti në punë**

Në rast të aksidentit në punë Kolegji është i detyruar të njoftojë Inspektoratin e Punës, sipas ligjit për mbrojtje dhe siguri ne punë, i cili përgatit procesverbalin me shkrim për gjendjen faktike lidhur me aksidentin e pësuar.

### **Neni 10 – Dispozitat përfundimtare**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Drejtues dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit Drejtues.

Prishtinë,

14 shkurt 2019

---

Rasim Mrlaku, Kryesues